

ZYRA E SPECIALIZUAR PËR PERSONAT E PREKUR NGA DHUNA

Konfidenciale. Pa pagesë. Për të gjithë. 052 625 25 00





Nuk e kisha menduar kurrë se do të më ndodhte mua.

A keni përjetuar ju vetë apo dikush i afërt me ju dhunë fizike, psikologjike apo seksuale? A ju kanë sulmuar fizikisht apo a jeni duke marrë kërcënime? Pavarësisht nëse keni përjetuar vetë apo keni qenë dëshmitarë të dhunës: Zakonisht vjen papritmas, shkakton ndjenja si p.sh. pa-

mundësi, mëri ose frikë dhe ta ndryshon rrënjësisht jetën. Ne nga zyra e specializuar për personat e prekur nga dhuna, ju mbështesim dhe këshillojmë në këto situata - nga përballimi psikologjik me përvojën e dhunës, deri te sqarimi i çështjeve ligjore dhe ofrimi i strehimit për raste emergjence.

 **Regjistrohuni te:**
052 625 25 00

Confidential. Free of charge.
For everyone.

Confidentiel. Gratuit.
Pour toutes et pour tous.

Confidencial. Gratis. Para todos.

Поверливо. Бесплатно. За сваког.

Konfidenciale. Pa pagesë. Për të gjithë.

Anonim. Ücretsiz. Herkes için.

ஹக்ஸிஃ டீஃ ௩௩௩௩ ஹஃ

Конфиденциально. Бесплатно. Для всех.

ரகசியமானது. இலவசம்.
அனைவருக்குமானது.

سري. مجاني. للجميع.

Download our Flyer
in your language
fsgb-sh.ch/downloads



Ne ju gjendemi pranë në raste dhune

Të gjitha bisedat janë tërësisht konfidenciale dhe mbulohen me konfidencialitet ligjor.

Dhuna në familje

- ▶ A ju ka goditur partneri/partnerja?
- ▶ Ndiheni të kërcënuar nga fëmija juaj?
- ▶ A abuzoheni verbalisht, ngacmoheni, lëndoheni apo detyroheni me forcë për diçka nga një familjar i juaj?
- ▶ A mos dikush pranë jush ka rënë pre e dhunës në familje?

Dhuna seksuale

- ▶ A ju kanë detyruar të kryeni akte seksuale?
- ▶ Keni përjetuar ngacmim seksual (p.sh. përmes fjalëve, gjesteve, prekjeve apo mesazheve) në punë/kohë të lirë/shkollë?
- ▶ A ju kanë përdhunuar apo sulmuar seksualisht?
- ▶ A mos dikush pranë jush ka rënë pre e dhunës seksuale?

Dhuna kundër fëmijëve dhe të rinjve

- ▶ A ju kanë rrahur apo goditur prindërit, të afërmit apo persona të tjerë?
- ▶ A ju ka kërcënuar, fyer apo shantazhuar ndokush në internet, në shkollë, në kohën e lirë apo në shtëpi?
- ▶ A ju ka detyruar ndokush me forcë të kryeni akte seksuale?
- ▶ Mos njihni ndokënd që ka rënë pre e dhunës?

Dhuna në përgjithësi

- ▶ A ju ka sulmuar e lënduar ndonjë person tjetër?
- ▶ A keni pësuar aksident rrugor duke pësuar lëndime?
- ▶ A ju ngacmon, ndjek apo shqetëson njeri në internet apo në jetën reale?
- ▶ A keni rënë pre e masave të detyrueshme të asistencës (shpërngulje me forcë)?
- ▶ A jeni përfshirë në një martesë të detyruar apo trafikim të qenieve njerëzore?
- ▶ A mos dikush pranë jush ka rënë pre e dhunës?

Ja si punojmë ne

Ne ju këshillojmë:

- për dhunën e pësuar.
- për planifikimin e hapave të radhës.
- për të drejtat tuaja si viktimë.
- për të paraqitur një ankesë penale.

Ne ju mbështesim me:

- procesimin e përvojës së dhunës dhe të pasojave të saj psikologjike.
- menaxhimin financiar të dhunës së pësuar.
- kërkesën për mbështetje profesionale, psikologjike dhe ligjore.
- kërkimin për strehim të përkohshëm.

Ne sqarojmë:

- se si mund të zbatohen hapat e radhës.
- çfarë pretendimesh financiare mund të ngrini.
- ku mund të merrni mbështetje të mëtejshme.



Këshillë për profesionistët

Kush mund të regjistrohet?

Të gjithë. Ne mbështetim punonjësit socialë, arsimtarët, mjekët, punëdhënësit, si dhe çdo person që ka kontakt me dhunën dhe ata që preken nga dhuna në kuadrin e jetës së përditshme profesionale.

Çfarë ofron zyra e specializuar?

Si zyrë e specializuar me njohuri të gjera për personat e prekur nga dhuna, ne ofrojmë hapësirë për përsiatje profesionale dhe konsulencë profesionale në subjektin e dhunës. Ne ju tregojmë mënyra me të cilat mund të ballafaqoni një dyshim për dhunë, ju informojmë për procedurat e mundshme, ju këshillojmë për qasjen ndaj personave të prekur nga dhuna dhe ju ndihmojmë të planifikoni hapat e radhës,

si dhe për të rritur ndërgjegjësimin në ambientin tuaj (të punës) për këtë temë.

Çfarë më ofron mua kjo konsulencë?

Së pari, do të mësoni se çfarë mund të bëni në rolin tuaj, si mund t'i mbështesni më së miri personat e prekur nga dhuna dhe cilat veprime do të përbënin pengesë. Do të ndërgjegjësoheni rreth subjektit të dhunës dhe do të kuptoni më mirë se çfarë e shkakton dhunën.

Kur duhet t'ju kontaktoj?

Me ne mund të lidhet cilido person, preferohet sa më herët të jetë e mundur. Ne ofrojmë edhe shërbime parandalimi për shkollë, klube, kompani etj. - dhe do të ishte kënaqësi t'ju prezantonim me to.



Fachstelle für Gewaltbetroffene
Neustadt 23 | 8200 Schaffhausen
Tel. 052 625 25 00
fachstelle@fsgb-sh.ch
www.fsgb-sh.ch

Orari telefonik:

E hënë – e premte: 08:00-12:00 dhe 13:30-17:00

